

KRITIKË DHE BIBLIOGRAFI**IZER MAKSUTI¹**

**PËR STUDIMIN MONOGRAFIK TË ALBANOLOGUT KURT
GOSTENTSCHNIGG: “SHKENCA MIDIS POLITIKËS DHE USHTRISË.
ALBANOLOGJIA AUSTRO-HUNGAREZE 1867-1918”/ (“WISSENSCHAFT
IM SPANNUNGSFELD VON POLITIK UND MILITÄR. DIE
ÖSTERREICHISCH-UNGARISCHE ALBANOLOGIE 1867-1918“)
WIESBADEN: SPRINGER VS 2018. (828 P., PRINT
–ON- DEMAND AND E-BOOK)**

Autori i monografisë në fjalë, Kurt Gostentschnigg (1965) historian, albanolog, gjermanist, përkthyes, shkrimtar e poet është emër i mirënjohur, dallohet si një ndër albanologët më të shquar austriak i kohëve të sotme, dhe si i tillë është pjesë dhe vazhdimësi e traditës së pasur të albanologjisë austro-gjermane.

Studiuesi është njohës i shkëlqyer i gjuhës shqipe, hapësirës dhe botës shqiptare në tërësi, po ashtu veprimtar aktiv përmes pjesëmarrjes nëpër konferenca shkencore dhe aktivitetet e ndryshme kulturore si në Vjenë, Grac, Muni, Regensburg, Tiranë, Shkodër, Prishtinë, Shkup e Tetovë etj., që kanë të bëjnë sidomos me këtë fushë dhe periudhë kohore që trajton monografia në fjalë.

Kurt Gostentschnigg bashkëpunon ngushtë me studiuesit më me nam austro-gjermanë dhe me hulumtuesit shqiptarë nga të gjitha viset e botës shqiptare.

Përshtypja e parë sapo ke në dorë këtë monografi, si për nga vëllimi me mbi 800 faqe, teksti i ngjeshur, ndërtimi, aparatura shkencore (me mbi 2500 fusnota), korpusi i pasur, literatura profesionale e shfrytëzuar mjaft e pasur, të bindin për peshën dhe vlerën që ka ky libër i rrallë në këtë fushë.

Peshën ia shtojnë edhe temat e trajtuara dhe periudha e gjatë kohore, vendimtare për filltet dhe zhvillimin e albanologjisë austro-hungareze 1867-1918 dhe në përgjithësi albanologjisë si shkencë.

Kjo monografi përbëhet prej gjithsej tetë pjesëve; nis me pjesën hyrëse, vijojnë pesë kapitujt kryesor konceptuar sipas fushave: shkencore, politike, ushtarake, fusha

¹ Prof. asoc. dr. Izer Maksuti, profesor i rregullt në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren; izer.maksuti@uni-prizren.com, dhe mësimdhënës në departamentin e Gjermanistikës, Universiteti i Tetovës. E-Mail: izer.maksuti@unite.edu.mk

e austrofilëve dhe interakcioni i fushave, kapitulli i gjashtë jep konkluzionet dhe i shtati përmban shtojcën me bibliografi dhe literaturën e shfrytëzuar.

Hyrja e monografisë trajton arsyet dhe stadin e hulumtimeve, mendimet teorike, qëllimet dhe çështjen e hulumtimit, metodën e studimit dhe teoritë mbi të cilat mbështetet studimi.

Kapitulli i parë themeltar “Fusha shkencore”, trajtuar në rreth 100 faqe, jep pasqyrën më përmbledhëse e më gjithëpërfshirëse për historinë e albanologjisë austro-hungareze që është paraqitur deri më tani. Në fillim përmenden aktorët individualë, ku në modelin e zërave enciklopedik ka të dhëna mbi jetën e albanologëve kryesorë austro-hungarezë: Johan Georg von Hahn (1811-1869) diplomat, hulumtues i Ballkanit, albanolog, Franz von Miklosich (1813-1891) gjuhëtar, sllavist, Hugo Schuchardt (1842-1927) romanist, Gustav Meyer (1850-1900) indogjermanist, specialist i filologjisë klasike, Ludwig von Thalloczy (1854-1916) politikan hungarez, historian, Konstantin Josef Jireček (1854-1918), Theodor Anton Ippen (1861-1935) diplomat dhe hulumtues i Ballkanit, Wilhelm Meyer-Lübke (1861-1936) romanist zviceran, Carl Patsch (1865-1945) historian dhe arkeolog, Franz Seiner (1874-1929) gazetar, gjeograf, kartograf, politikan, Georg Veith (1875-1925) historian, Norbert Jokl (1877-1942) indogjermanist dhe albanolog, Franz Nopcsa (1877-1933) etnograf, albanolog, Milan Šufflay (1879-1931), Maximilian Lambertz (1882-1963), gjuhëtar, albanolog, Camillo Praschniker (1884-1949) arkeolog, filolog, Arnold Schober (1886-1959) arkeolog, Arthur Haberlandt (1889-1964) etnolog, Karl Steinmetz, inxhinier austriak, shkrimtar.

Pason nënkaptulli ku trajtohen fillet e ballafaqimit shkencor me Shqipërinë, roli i qendrave të hulumtimit, universiteteve në Vjenë, Grac, Budapest, Prag e Zagreb, Akademia e Shkencave në Vjenë dhe dy komisionet: i Ballkanit dhe i Shqipërisë, programet e hulumtimit në kuadër të këtyre Komisioneve dhe veprimi i “Albanien-Kommission” në kuadër të “Balkan-Kommission”. Këtu trajtohen po ashtu edhe udhëtimet studimore nxitur dhe organizuar nga këto dy komisione. Në nënkaptullin e radhës 1.4 trajtohet primati i hulumtimeve të Ballkanit nga Akademia Hungareze e Shkencave si dhe udhëtimet studimore mbështetur nga kjo akademi. Me shumë vlerë janë edhe nënkaptujt e radhës mbi Carl Patsch-in dhe Institutin e Ballkanit në Sarajevë, si dhe “Çështja e etnogjenezës shqiptare” ku jepet një pasqyrë përmbledhëse e atij debati shumëvjeçar mbi prejardhjen e shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe, duke vlerësuar hulumtimet dhe teoritë e ndryshme mbi ata; çështje kjo ende aktuale dhe e ndjeshme e autoktonisë së tyre dhe teoritë e prejardhjes: ilire, trake, apo asnjërës prej tyre. Nënkaptulli i radhës flet për “Hulumtimet në terren” në Shqipëri rreth mesit të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX në shembullin e udhëtimeve të Hahn-it dhe Nopcsa-s.

E theksoj që studiuesi Kurt Gostentschnigg nocionin “Albanologji” e koncepton në një kuptim më të gjerë, siç ka qenë që në fillim të konsolidimit si shkencë edhe në atë kohë duke përfshirë më shumë disiplina si: gjuhësinë, historinë, etnologjinë, gjeografinë/gjeologjinë dhe arkeologjinë.

Më tutje pasojnë të dhënat mbi arritjet e shkencëtarëve më të rëndësishëm austro-hungarezë në fushë të albanologjisë, duke i ndarë sipas fushave studimore që përmendëm më sipër. Peshën e kësaj monografie ia shton edhe më shumë vlerësimi kritik i arritjeve dhe veprës të secilit prej këtyre albanologëve për çdo fushë veças. Përmbledhja e detajuar dhe analiza me vlerë e përmbyll kapitullin e parë mbi “Fushën shkencore”.

Në kapitullin e dytë “Fusha politike”, vazhdohet sipas modelit të kapitullit paraprak të përmenden dhe jepen të dhëna mbi aktorët individualë të kësaj fushe. Dallojmë këtu këta përfaqësues: Ludwig von Thalloczy (1854-1916) politikan hungarez, historian, Theodor Anton Ippen (1861-1935) diplomat dhe hulumtues i Ballkanit, Leopold Graf Berchtold (1863-1942) ministër i jashtëm, Alfred Rappaport (1868) konsull në Shkodër, August Kral (1869-1953) diplomat, konsull në Shkodër, Manastir, Selanik etj., ku për të secilin prej tyre jepen të dhëna bibliografike. Materiali mbi organizimin e Ministrisë së Jashtme, strukturën dhe seksionet, referatat për orient dhe Ballkan, nëpunësit e ministrisë si dhe grupet e lobimit pasojnë në nënkapitullin e radhës. Vazhdohet me rolin kyç të Shqipërisë në kuadër të konceptit politik ballkanik të Austro-Hungarisë. Këtu autori ndalet gjerë e gjatë për shumë nëntema duke nisur që nga rrethanat e viteve 1867, Çështja e orientit 1866-1875, Kriza e orientit 1875-1878 dhe Kongresi i Berlinit, propaganda e kohës, Politika e Ballkanit në raport me zhvillimet e kohës, dështimi i politikës dhe Status Quo-ja 1909-1914. Në këtë kryekapitull të dytë nuk harrohet të përmenden edhe fakte mbi zhvillimin ekonomik të Austro-Hungarisë, përkushtimin ekonomik për vendet e Ballkanit, udhëtimet me anije në Danub, ndërtimi i hekurudhës, kontratat e tregtisë, funksioni tregtar-politik i Shqipërisë për Austro-Hungarinë dhe Komitetin austriak për Shqipërinë (Albanien-Komitee). Mendoj që me shumë interes është nënkapitulli 2.5 që flet për “Kultusprotektoratin” si kornizë ligjore të marrjes së ndikimit për interesa vetjake. Këtu autori ndalet te zhvillimi dhe detyrat e “Kultusprotektoratit” mbrojtjet prej sulmeve, për ndihmesën e ngritjeve të shkollave në Shqipëri deri te Konvikti Shqiptarë në Vjenë. Tema tjera me një rëndësi më të veçantë që trajtohen në këtë kapitull të “Fushës politike” sipas meje janë: roli i konsujve, ndihmesa e Austrisë për sistemin shkollor, në çështjen e alfabetit, si dhe për botime të ndryshme, gazeta e revista. Po ashtu me shumë interes janë nënkapitujt për Ludwig von Thalloczy-n dhe historiografinë e Shqipërisë, periudhën e pushtimit të Shqipërisë nga fuqitë e mëdha gjatë kësaj periudhe, si dhe nënkapitulli për një personalitet jo shumë të njohur sa duhet prej opinionit shqiptar, Leo Freundlich si publicist në shërbim të politikës dhe ekonomisë. Edhe kapitulli i dytë mbaron sipas shembullit të mëparshëm me një përmbledhje dhe analizë të detajuar.

Kapitulli i tretë “Fusha ushtarake” nis me aktorët individualë, organizimin e Ministrisë së Luftës, Shtabin gjeneral, rolin e Shqipërisë për Austro-Hungarinë nga pikëpamja e këtij shtabi gjeneral, planet për krijimin e një “Force të Armatosur Shqiptare”, si dhe mbështetjen për Princin Wied. Këtu nuk duhet të lëmë pa

përmendur sidomos “Raportet informative mbi Shqipërinë”, si dhe nënkapitujt me të dhëna të mjaftueshme mbi aksionet ushtarake kundër Serbisë dhe Italisë. Me mjaft interes këtu është edhe nënkapitulli 3.8 që flet për Komandon e Korpusit 19-të në zonat e pushtuara shqiptare 1916-1918.

Kapitulli i katërt “Fusha e Austriafilëve” nis me një vështrim mbi zhvillimin e lëvizjes kombëtare shqiptare që në fillim të shek. XIX, duke vazhduar me Veriun e Shqipërisë (Klerin Katolik, parinë e fiseve), më pas me Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut (Agallarët, bejlerët, familjen Toptani në Tiranë dhe familjen Vlora në Vlorë). Gjejmë të dhëna edhe për administratën osmane të kohës, zhvillimin e “Partive Kombëtare” 1908 – 1904 si dhe për aktorët individualë, nisur me austrofilin Gjergj Pekmezini (1872-1938) rolin e tij si gjuhëtar, mësues gjuhe, botues etj., Syrja bej Vlorën (1860-1940), Prek Doçin (1846-1917), Faik bej Konicën (1875-1942), Lazër Mjedën (1869-1935), Eqrem bej Vlorën (1885-1964), Prek Bibë Dodën (1858-1919), Pashk Trokshi (1850-1917), Jak Sereqi (1861-1922), Luigj Gurakuqi (1879-1925), Ahmed Zogu (1895-1961), Fazil pashë Toptani, Ismail bej Vlora (1844-1919), Aqif pashë Elbasani (1860-1926), Myfit bej Libohova (1876-1927), Ferit bej Vlora (1851-1914), Bajram Curri (1862-1925), Hasan bej Prishtina (1873-1933), Isa Boletini (1864-1916), Marka Gjoni (1861-1925), Zef Curani dhe Sali bej Butka (1852-1938). Për të gjithë këta autori jep të dhëna për jetën dhe veprën, sidomos për raportin e tyre me Austrinë. Këtu përmendet pesha dhe roli i këtyre aktorëve austrofilë gjatë Luftës së Parë Ballkanike 1912, si dhe për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Kapitulli i pestë “Interaksioni i fushave” flet fillimisht për fenomenin kompleks të ndërveprimit të fushave të albanologjisë, politikës, ushtrisë dhe austrofilëve. Këtu me shumë interes janë përshkrimet për “Udhëtimet hulumtuese” para Luftës së Parë Botërore, si dhe përgjatë administrimit ushtarak nga Austro-Hungaria 1916-1918. Tema tjera kyçe në këtë kryekapitull janë: “Alfabeti i Kongresit të Manastirit nëntor 1908”, si dhe “Komisia Letrare e Shkodrës dhe revista shqiptare “Vellazënia” në Vjenë 1916-1918”. Këtu duhet theksuar veçmas mbështetja e Austro-Hungarisë dhe roli i albanologut Maximilian Lambertz në kudër të kësaj “Komisie”.

Kapitulli i gjashtë “Conclusio: Fusha e Pushtetit si motor për imperializmin kulturor përmes dhunës strukturore dhe kulturore”. Këtu me shumë finesë nga autori trajtohet raporti dhe ndërthurja shkencë-pushtet dhe instrumentalizimi i dijes shkencore nga pushteti.

Kapitulli i shtatë përmban shtojcën me një bibliografi me shumë vlerë të albanologjisë austro-hungareze me mbi 500 tituj, të një periudhe kohore të botimeve prej 1855 deri 1918, ku janë përfshirë gati të gjithë botimet e albanologëve austro-gjermanë. Po ashtu në shtojcë gjejmë edhe literaturën profesionale me mbi 500 tituj dhe burimet e materialeve arkivore. Literatura e shfrytëzuar në më shumë se 5 gjuhë: gjermanisht, shqip, anglisht, frëngjisht, hungarisht e serbo-kroatisht është dëshmi shtesë e potencialit të studimit dhe studiuesit.

Akribia shkencore, korpusi i pasur, shfrytëzimi i arkivave të ndryshme në Vjenë, Budapest e Tiranë, literatura profesionale, e bëjnë këtë studim monografik, hartuar në një gjuhë të rrjedhshme e tepër të pasur, më gjithëpërfshirës dhe më me peshë. Do të ketë qenë një sfidë dhe detyrë jo tepër e lehtë e autorit për të trajtuar këtë temë të gjerë, me karakter interdisiplinar dhe për një periudhë kohore rreth 50 vjeçare, që mendoj se ia ka dalë mban me sukses. Këtij studimi i shtohet edhe më shumë vlera edhe për albanologjinë në përgjithësi, sepse trajton më së miri fillet, themelimin, zhvillimin dhe kohën e lulëzimit të albanologjisë austro-hungareze.

Gjatë prezantimeve të kësaj monografie si në hapësirën gjermanishtfolëse, ashtu edhe në atë shqipfolëse, studimi dhe autori i saj kanë marrë vlerësimet më të larta; mendimin e njëjtë e ndaj edhe unë.

Punimet e shumta deri më tani dhe sidomos përfundimi dhe botimi i kësaj monografie e bënë Kurt Gostentschnigg njohësin më të mirë të kësaj fushe dhe periudhe, si nga radhët e studiueseve të huaj edhe nga ato shqiptarë.

Studimet e shumta dhe kjo monografi tepër voluminoze dhe përmbajtjesore është dëshmi që bëhet fjalë për një studiues serioz, tepër produktiv dhe ende premtues që duhet mbështetur për të vazhduar hulumtimet në këtë fushë. Studiues të tillë duhen përkrahur dhe shpresoj që Kurt Gostentschnigg të gjej mundësi dhe mbështetje të vazhdoj hulumtimet në këtë fushë, për të nxjerrë në dritë vepra me shumë vlerë siç është monografia në fjalë. Uroj që të sipas këtij shembulli autori të ketë mundësinë të hulumtoj edhe tema tjera të albanologjisë austriake, si për shembull periudhën në mes të Dy Luftërave Botërore, kohë kjo kur Austria dhe qytete si Vjena e Graci vazhduan të mbeten dhe të veprojnë si kryeqendra të albanologjisë.

